

VENDIM
Nr. 184, datë 10.11.2017

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË MTC ENERGY SHPK, PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE PRANË RAIFFEISEN BANK, PËR EFEKT TË
RISTRUKTURIMIT TË KREDISË**

Në mbështetje të neneve 16; 20, pika “a” dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 7 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; të pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi refuzimin e transferimit të aseteve të shoqërisë MTC Energy sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 101, datë 4.7.2017, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë MTC Energy sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të bankës Raiffeisen Bank sh.a.

Në vijim të vendimmarrjes së sipërcituar, ERE njoftoi shoqërinë MTC Energy sh.p.k., me shkresën nr. 158/1 prot., datë 21.9.2017, për detyrimin e plotësimit të dokumentacionit të munguar brenda 15 ditësh.

Edhe pas kalimit të këtij afati rezulton se subjekti ende nuk ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, në pajtim me nenin 7, pika 1, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”.

Mungesa e dokumentacionin konsiston si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, geramat: “c”, gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve; “f”, efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit; “g”, efektin në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar.

- Neni 7, pika 3, subjektet koncesionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e autoriteti shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë MTC Energy sh.p.k. për transferimin e aseteve pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

